



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Më datë **06.12.2018**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Kontroll Kufitar Aerodrom Ohër.

Vizita buron nga mandati i Avokatit të Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, e cila është parashikuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ definohet zbatimi i vizitave të rregullta në vendet ku mund të kryhet privimi nga liria i personave, me qëllim të identifikimit të rreziqeve dhe parandalimit të torturës ose llojeve tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN hasi në bashkëpunim dhe kooperim të mirë nga ana e personave zyrtarë të punësuar në Stacionin Policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Në hapësirën e kujdestarisë, e cila gjendet në fillim të hyrjes së Stacionit Policor në vend të dukshëm është vendosur “Kodeksi i etikës policore”, si dhe janë vendosur edhe udhëzimet për të “Drejtat e viktimave të veprave penale”, në më shumë gjuhë, si dhe udhëzimet “A i dini të drejtat tuaja”.

Gjatë këqyrjes në zyra nuk janë vërejtur mjete dhe as sende të tjera të dyshimta, me të cilat do të mund të kryhej frikësimi i personave të arrestuar, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar.

Stacioni Policor nuk disponon me hapësirë të veçantë për azilkërkuesit, si dhe nuk janë vërejtur informata për azilkërkuesit. Gjithashtu, Stacioni Policor nuk ka listë të avokatëve, të regjistruar në kalendarin e lëshuar nga Dhoma e Avokatëve të RMV, në rastet kur të thirrurit, të arrestuarit dhe personat e privuar nga liria, dëshirojnë ta shfrytëzojnë të drejtën e thirrjes së mbrojtësit.

Ekipi i MPN konstatoi se në SP për KK Aerodrom Ohër për nëpunësit policorë organizohen trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme me përmbajtje tematike nga më të ndryshme, ndërsa një pjesë e nëpunësve policorë më me përvojë mbajnë trajnime si mentorë.

Stacioni Policor për KK Aerodrom Ohër, nuk ka hapësira të veçanta për ndalimin e personave, të cilëve u është refuzuar hyrja në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në rastet kur ka nevojë për ndalim në Stacion, bisedat i zhvillojnë në zyrën e zëvendës-eprorit.

Ekipi i MPN konstatoi se, SP i KK Aerodrom Ohër nuk disponon me bazë të përkthyesve ose interpretuesve të autorizuar në gjuhë të huaja.

Ekipi i MPN konstatoi se vërehet informim i pamjaftueshëm i nëpunësve policorë nga fusha e azilit dhe nivel i ulët i njohjes së masave që kanë të bëjnë me referimin e personave të cilët kanë nevojë ose qëllim të kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Higjiena në ambientet ishte në nivel adekuat, ndërsa në zyrën e zëvendës-eprorit, në të cilën zhvillohen biseda në situata të jashtëzakonshme me personat të cilët janë arrestuar për kohë të shkurtër në Stacionin Policor, nuk ishin vendosur udhëzimet për të drejtat.

Ekipi i MPN, gjatë këqyrjes në regjistrat për evidentim, konstatoi se nga ana e nëpunësve policorë është vërejtur lëshim, më saktë një dosje nuk ishte e aksesshme, prandaj ky stacion policor duhet t'i ruaj dhe t'i ketë të aksesshme në çdo kohë dokumentet për të gjitha ngjarjet e ndërmarra gjatë punës.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe drejtoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te eprori i Stacionit Policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë e theksuara dhe të përmirësohen kushtet dhe veprimi me personat e privuar nga liria, personat e paraburgosur dhe personat e ndaluar.